



Informacionet e përmbajtura në këtë broshurë janë të përgjithshme. Për të patur informacione të personalizuar në lidhje me situatën tuaj, ne ju ftojmë të kontaktoni CIDFF më pranë jush ku ju mund të informoheni, të shoqëroheni dhe të orientoheni drejt profesionistëve kompetentë.

Informacioni është konfidencial dhe falas.

Ka gjithsej **103 CIDFF** (Qendra informacioni mbi të drejtat e femrave dhe familjeve) në Francë dhe në disa DOM-TOM me mundësi takimi të shumta.

Me siguri që ka dhe një pranë jush : ju do të gjeni të dhënat e CIDFF në faqen **fncidff.info**



FNCIDFF - 7, rue du Jura - 75013 Paris - 01 42 17 12 00 - fncidff@fncidff.fr

fncidff.info

Kjo broshurë informacioni është realizuar nga FNCIDFF në kuadrin e një partneriteti me Drejtorinë e pritjes, të shoqërimit të të huajve dhe të nënshtetësisë (DAAEN) dhe në bashkëpunim me CIDFF të Aube, Bouches-du-Rhône/Phocéén, Essonne, Haute-Garonne, Hauts-de-Seine/Nanterre, Rhône, Val d'Oise.

© FNCIDFF - 2020

Barazia midis femrave et dhe meshkujve

Aksesi i të drejtave për femrat e **sapo-ardhura**



Në Francë, femrat dhe meshkujt janë të barabartë dhe kanë të njëjtat të drejta. Në rast mos-respektimi, dënime parashikohen nga ligji.

Barazia e të drejtave femër mashkull në Francë

Familja

- > Martesa është e ndaluar për femrat si dhe për meshkujt para moshës 18 vjeçare. Femrat dhe meshkujt nuk mund të detyrohen të martohen.
- > Femrat dhe meshkujt janë të lirë të bashkëjetojnë, nëse janë të martuar ose të pamartuar, të divorcojnë apo të ndahen. Dëbimi nga banesa është i ndaluar.
- > Femrat dhe meshkujt marrin së bashku vendimet në lidhje me buxhetin e familjes dhe janë që të dy përgjegjës për këtë.

Dhunimet

- > Dhunimet (fizike, psikologjike, seksuale dhe verbale) brenda çiftit dhe brenda familjes janë të ndaluara dhe të dënuara.
- > Një marëdhënie seksuale me forcë quhet përdhunim edhe nëse kjo gjë ndodh brenda çiftit. Është një krim që dënohet nga ligji.
- > Çdo dhunë e ushtruar ndaj femrave është e ndaluar dhe e dënuar.

Trupi/shëndeti

- > Gjymtimet seksuale tek vajzat dhe gratë janë të ndaluara.
- > Femrat kanë të drejtë të vendosin lirisht të bëjnë apo mos të bëjnë fëmijë.
- > Femrat mund të vendosin lirisht të marrin kontraktiv apo ti japin fund me dëshirë shtatëzanisë së tyre (Aborti).

Edukimi/prindërimi

- > Nëna dhe babai kanë të njëjtat të drejta dhe detyra mbi fëmijët e tyre.
- > Shkolla është e detyrueshme për vajzat si dhe për djemtë duke filluar nga moshë 6 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare.
- > Vajzat kanë të drejtën të marrin të njëjtin edukim si dhe djemtë.

Punësimi

- > Femrat dhe meshkujt kanë të drejtë të ushtrojnë çdo lloj profesioni në të njëjtat kushte dhe me të njëjtën rrogë.
- > Femrat kanë të drejtë të punojnë pa kërkuar lejen e bashkëshortit të tyre, të babait apo të një pjesëtari të familjes së tyre.
- > Femrat e marrin vetë rrogën e tyre dhe mund të hapin një llogari bankare në emrin e tyre.

Liria individuale

- > Çdo person ka të drejtë të praktikojë fenë që dëshiron apo të zgjedhë të mos ketë fare fe.
- > Femrat mund të vishen sipas dëshirës së tyre. Megjithatë mbulesa e plotë e trupit është e ndaluar në ambientet publike.
- > Femrat mund të bëjnë zgjedhje dhe të marrin vendime pa autorizimin e bashkëshortit të tyre, të babait apo të një pjesëtari të familjes së tyre (të dalin, të hapin një llogari bankare, të punojnë, të ngasin makinën...).